

Pasqyra e Dhënave Mjedisore dhe Sociale

Vështrim i përgjithshëm

Emri i Projektit: TAP – Gazsjellësi Trans Adriatik Numri i Projektit:
Shteti: *Greqi, Shqipëri, Itali*
Përshkrimi i Projektit: Projekti ka të bëjë me ndërtimin dhe vendosjen në punë të Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP), i cili përfaqëson pjesën e Korridorit Jugor të Gazit që fillon me kufirin greko-turk dhe shtrihet përgjatë Shqipërisë dhe vazhdon në Itali, me një gjatësi totale prej 870 km.
A kërkohet VNM: Po
A përfshihet projekti në Studimin e Gjurmës së Karbonit¹: Po
(detajet për projektet e përfshira gjenden në seksionin: “Studimi i Gjurmës së Karbonit i BEI-së”)

Vlerësimi Mjedisor dhe Social

Projekti përfshin ndërtimin dhe vendosjen në punë të Projektit të Gazsjellësit Natyror Trans Adriatik (TAP) nga kufiri turko-grek për në Italinë Jugore nëpërmjet Greqisë, Shqipërisë dhe Detit Adriatik. TAP është pjesë e zhvillimit të Korridorit Jugor të Gazit², i cili lidh fushën e gazit Shah Deniz 2 të Azerbajxhanit me Turqinë dhe Evropën.

Seksioni TAP konsiston në ndërtimin e një tubacioni gazi me një gjatësi prej 878 km, që do të lidhet me Gazsjellësin Trans Anatolian (TANAP) në kufirin greko-turk, pranë Kipoi- Greqi, pastaj do të kalojë nëpër Greqinë Veriore, Shqipërinë dhe Detin Adriatik, përpara se të mbërrijë në bregun e Italisë Jugore, për t'u lidhur me rrjetin italian të gazit. Tubacioni është i futur në tokë përgjatë të gjithë gjatësisë së tij; megjithatë, sistemi i tubacionit kërkon një sërë instalimesh mbi sipërfaqen e tokës, të llojeve të ndryshme:

- Dy stacione kompresori, njëri në afërsi të Kipoi në Greqi dhe tjetra afër Fierit në bregun shqiptar;
- Një stacion për inspektimin e tubacionit në afërsi të Serresit në Greqi;
- Një stacion matjeje dhe inspektimi në afërsi të Bilishtit në Shqipëri;
- Stacione valvulash bllokimi në tokë në Greqi dhe Shqipëri dhe në secilën anë të Detit Adriatik;
- Një terminal për pritjen e gazsjellësit (PRT) në afërsi të Leçes, Itali;

¹ Vetëm projektet që përputhen me qëllimin e Studimit pilot, siç përcaktohet në Projekt-metodologjitë e Gjurmës së Karbonit të BEI-së, me kusht që emetimet e përlogaritura të tejkalojnë prapun e metodologjisë: rreth 100 000 ton CO₂e/vit absolute (bruto) ose 20 000 ton CO₂e/vit relative (neto) - si shtesat edhe kursimet.

² Korridorit Jugor i Gazit përbëhet nga komponentët e mëposhtëm: i) fusha e gazit Shah Deniz 2, ii) Tubacioni Jugor i Kaukazit dhe zgjerimi i tij përmes Azerbajxhanit dhe Gjeorgjisë për në Turqi, iii) ndërtimi i TANAP përmes Turqisë për në Greqi dhe iv) ndërtimi i Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP) përmes Greqisë, Shqipërisë dhe Detit Adriatik për në Italinë Jugore.

Duke pasur parasysh shkallën dhe numrin e madh të aspekteve mjedisore dhe sociale të Projektit, ai është përballur me një sërë sfidash komplekse mjedisore dhe sociale. Promovuesi është i angazhuar në arritjen e rezultateve të qëndrueshme dhe po bën përpjekje për të garantuar që Projekti të ndërtohet dhe vihet në punë sipas praktikës së mirë ndërkombëtare dhe kërkesave dhe Standardeve Mjedisore dhe Sociale të Huadhënësve.

Gjurma e gazsjellësit kalon përmes një sërë mënyrash të përdorimit të tokës, që prekin rreth 21 000 parcela toke, të cilat shfrytëzohen nga familjet vendase. Problemet shoqërore dhe mjedisore të hasura, të cilat janë tipike për këtë infrastrukturë të madhe dhe komplekse, përfshijnë: opsionet e kufizuara rajonale për gjurmë për shkak të vështirësive komplekse mjedisore, sociale, rreziqeve gjeografike dhe gjeopolitike; ndikimin e madh të mundshëm në habitatet e ndjeshme të florës dhe faunës, tokësore dhe detare, si dhe në burimet ujore sipërfaqësore dhe nëntokësore; marrjen e përkohshme të tokës nën sistemet komplekse të përdorimit të tokës; shqetësimet ndaj jetesës vendase dhe aktiviteteve që prekin një numër të madh njerëzish; sigurinë e komunitetit; punësimin vendas; ndikimet potenciale tek grupet e marginalizuara dhe vulnerabël (duke përfshirë pakicat etnike, gratë dhe të moshuarit); si dhe implementimin e një konsultimi dhe angazhimi të madh publik, duke përfshirë programin e publikimit.

Projekti ka tërhequr vëmendje të madhe të grupeve të interesit, shtypit dhe shoqërisë civile, duke përfshirë edhe OJQ-të ndërkombëtare. Projekti ka qenë edhe subjekt i një numri të madh ankesash nga komunitetet që preken nga Projekti dhe OJQ-të, drejtuar edhe ndaj BEI-së, si dhe kundërshtime ndaj projektit, të regjistruara kryesisht në Greqi dhe Itali.

Vlerësimi mjedisor

Për secilin nga tre vendet është përgatitur një VNMS gjatë viteve 2012-2014, siç kërkohet nga legjislacioni përkatës kombëtar dhe kërkesat e BE-së, si dhe janë dhënë pëlqimet për zhvillimin e projektit në janar 2013 (Shqipëri) dhe shtator 2014 (Greqia dhe Italia). Në mbështetje të ndryshimeve në Projekt janë paraqitur amendamente të tjera për VNMS-në, të cilat lidhen kryesisht me ndryshimet në të Drejtën e Kalimit (DeK). Objekti i vlerësimeve të ndikimit përfshin gjurmën e gazsjellësit, të përcaktuar 50 m (për trashëgiminë kulturore), 500 m (për bazën mjedisore) dhe 2 km korridore të gjera (për bazën social-ekonomike), të gjitha infrastrukturat përkatëse dhe një analizë për rrugë alternative.

Megjithëse niveli i VNMS-ve i tejkalon kërkesat kombëtare të të tri vendeve pritëse, objekti i tyre nuk adresoi plotësisht kërkesat e Huadhënësve (ku përfshihet dhe BEI), duke përfshirë kërkesat që lidhen me ndikimet kumulative, biodiversitetin (detar dhe tokësor) dhe vlerësimet kritike të habitateve, erozionin dhe rreziqet gjeografike, angazhimin e grupeve të interesit dhe sistemet e menaxhimit Mjedisor, Social, Shëndetësor dhe të Sigurisë (MSShS), dhe menaxhimin e kontraktorit. Për këtë arsye, u kërkuan studime, raporte dhe plane menaxhimi plotësuese për ndikimin. Bashkëpunimi i madh midis Huadhënësve ishte i domosdoshëm për të përcaktuar fushën e secilit informacion plotësues, për të marrë parasysh MSShS-në dhe politikat e punës të secilit institucion financiar. Duke pasur parasysh kohën e vëmendjes së veçantë dhe kalendarin e Projektit, informacioni plotësues u përqendrua kryesisht në ndikimet nga ndërtimet, duke përfshirë ndikimet mjedisore, shëndetësore dhe të sigurisë, biodiversitetin, kushtet e punës dhe sigurinë, si dhe ndikimet sociale (p.sh. kompensim për servitudin dhe instrumentet ndihmëse), angazhimin me komunitetet dhe leja sociale për të zbatuar Projektin. Përveç këtyre, vëmendja e veçantë e BEI-së ka marrë parasysh kontributin e palëve të ndryshme të interesuara, si vendase edhe ndërkombëtare.

Pajtueshmëria me Kërkesat e Huadhënësve: Secili nga Standardet M&S të EIB-së janë analizuar dhe aspektet e pa-adresuara plotësisht në dokumentet origjinale, u mbuluan nga informacioni plotësues në Paketën Plotësuese Informative të Huadhënësve (PIIH). Fushat me

interes të lartë dhe që ishin kritike për BEI-në përfshinin: (i) sistemet e menaxhimit mjedisor, shëndetit social dhe sigurisë të Promovuesit dhe kontraktorëve e nënkontraktorëve të ofruesit të shërbimeve dhe kontraktorëve dhe nënkontraktorëve të saj (PPN), të cilat përfshijnë kapacitetin e Promovuesit në menaxhimin e Projektit; (ii) të krijohet angazhimi i përshtatshëm i komunitetit në mënyrë që të zgjidhë disa nga kundërshtimet ndaj Projektit dhe të rikthejë besimin e një sërë komunitetesh; (iii) marrjen e tokës dhe planin e restaurimit të jetesës përgjatë rrugës së gazsjellësit, i cili parashikon procedura për kryerjen e konsultimeve, negociatave dhe kompensimit për marrjen e servitudit të së Drejtës së Kalimit (DeK) nga ana e Promovuesit, duke marrë parasysh strukturat shoqërore specifike të vendit; (iv) mbrojtjen e biodiversitetit detar dhe tokësor në përputhje me hierarkinë lehtësuese; (v) trashëgiminë kulturore; (vi) programet e monitorimit të krijuara nga grupi i Huadhënësve nëpërmjet këshilltarëve të M&S për seksionet që ishin në ndërtim në kohën e vëmendjes së veçantë; dhe (vii) vijimi i angazhimit të palëve të interesuara dhe publikimi i informacionit.

Standardet Mjedisore dhe Sociale të Projektit: Standardet Mjedisore dhe Sociale të Projektit përmbledhin standardet dhe udhëzimet kombëtare dhe ndërkombëtare që do të zbatohen në Projekt, e që përfshijnë (i) standardet numerike që zbatohen në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar për emetimet e ajrit, cilësinë e ajrit të ambientit, ujërat sipërfaqësore (si të freskëta edhe detare), zhurmën, rehabilitimin e tokës etj., duke treguar standardet që janë miratuar për Projektin; (ii) përshkrimin gjithëpërfshirës të kërkesave minimale të domosdoshme për të qenë në përputhje me qëllimin e Konventave Ndërkombëtare përkatëse ku të tri shtetet janë palë, të gjitha Standardet dhe udhëzimet në fuqi të Huadhënësve, dhe (iii) një përzgjedhje të praktikave ndërkombëtare në fushat ku nuk ka standarde kombëtare apo të Huadhënësve.

Përzgjedhja e rrugës: Përzgjedhja e rrugës së tubacionit ka qenë një proces përsëritës, i bazuar në analiza të shumta, duke përdorur kriteret fizike, teknike, biologjike, arkeologjike dhe sociale së bashku me disponueshmërinë e hapësirave për ndërtimin e tubacionit. Me përzgjedhjen e rrugës së preferuar filloi procesi i verifikimit të rrugës, me qëllim vlerësimin e devijimit lokal të rrugës përmes seksioneve që kanë paraqitur sfidat më të mëdha teknike, mjedisore, sociale, ekonomike, të sigurisë dhe trashëgimisë kulturore, si dhe konflikte me infrastrukturën tjetër në zonë. Pavarësisht se u zhvilluan konsultime gjithëpërfshirëse mbi opsionin e zgjedhur, reagimet nga komunitetet vendase rreth rrugës së përzgjedhur të tubacionit apo alternativave të tjera nuk kanë qenë të mjaftueshme në Greqi, dhe gjithashtu edhe në Itali e Shqipëri për sa ka të bëjë me daljet në det. Kjo ka shkaktuar kritika, veçanërisht nga komunitetet vendase që preken në Greqi dhe Itali.

Ndikimet kumulative: Me kërkesë të Huadhënësve, Projekti përgatiti një vlerësim të ndikimit kumulativ (VNK) brenda një fushe ndikimi (FN), e cila u shtri në 20 km të secilës anë të pjesës tokësore të tubacionit dhe 50 km në pjesën detare të tubacionit. Kjo FN përfshiu aktivitetet dhe objektet në pronësi, në përdorim dhe menaxhim nga TAP-i, aktivitetet mbështetëse ose mundësuese, pasuritë ose objektet që zotërohen ose menaxhohen nga të tjerë por që lidhen me Projektin, zhvillimet e paplanifikuara por të parashikueshme, zhvillimet e planifikuara nga palët e treta, ndikimet e tërthorta dhe të detyruara si dhe objektet e shoqëruara me Projektin. Metodologjia u bazua në konceptin e komponentëve me vlerë mjedisore dhe sociale (KVM-të) dhe përfshiu një proces metodologjik të identifikimit dhe vlerësimit të të gjithë ndikimeve kumulative në KVM-të. VNK-ja ndoqi Manualin e Praktikave të Mira mbi VNK (2013) të IFC-së. Ndikimet kumulative u vlerësuan pa lehtësira shtesë. VNK-ja arriti në përfundimin që, në përgjithësi, nuk mund të rrjedhë asnjë efekt domethënës kumulativ nga ndërveprimet me aktivitetet e tjera dhe zhvillimet, me përjashtim të KVN-ve në vijim në

(i) zonën e mbrojtur Agios-Timotheos-Kioupia, (ii) pyllin e Evrosit Jugor, (iii) korridori i degëzimit lumor të Loutros, (iv) lumi Strymonas, (v) zona Vithkuq-Oshovicë dhe lugina e Osumit, dhe (vi) zona Seman-Pishë-Poro. Këtu do të nevojiteshin vlerësime të mëtejshme e të detajuara për të kuptuar më mirë ndikimet dhe për t'u informuar rreth Biorestaurimit, planeve të Menaxhimit Ekologjik si dhe Strategjisë së Kompensimit. Janë zhvilluar shumë pak konsultime publike mbi VNK-të dhe ato u kufizuan vetëm me subjektet qeveritare.

Infrastruktura dhe objektet që lidhen me të: Nëpërmjet qasjes së bazuar në rrezik, BEI-ja ka vlerësuar rreziqet mjedisore dhe sociale të projekteve kyçe në rrjedhën e sipërme dhe të poshtme të TAP-it (fusha e gazit Shah Deniz 2, Tubacioni Jugor i Kaukazit dhe zgjerimi i tij përmes Azerbajxhanit dhe Gjeorgjisë për në Turqi, TANAP, SNAM Rete Gas) bazuar në ndikimet e mundshme të mbetjeve, pas implementimit të strategjive, sistemeve dhe planeve ekzistuese ose të propozuara të menaxhimit. I gjithë dokumentacioni mbi M&S i disponueshëm për publikun, u rishikua së bashku me informacionin shtesë të vënë në dispozicion pranë Bankës nga aksionerët dhe IFN-të që mbështesin projektet e lidhura. Janë përgatitur VNMS-të për projektet e lidhura, në përputhje me praktikën e mira ndërkombëtare të konsulentëve vendorë dhe ndërkombëtarë, në konsultim me autoritetet vendase dhe angazhimin e duhur të palëve të interesuara. Konkretisht, në lidhje me fushën e gazit Shah Deniz 2, është kryer një auditim mbi përputhshmërinë mjedisore dhe sociale, në pajtim me Kërkesat e Performancës së BERZH-it dhe politikën e Sigurisë së BAZH, si dhe është hartuar një Plan përkatës Masash Mjedisore dhe Sociale. Nuk u identifikua asnjë mospërputhje me politikën dhe standardet e tyre përkatëse për M&S. Në lidhje me projektin TANAP, ky projekt u vlerësua nga Banka Botërore në përputhje me Politikën Operacionale të Bankës Botërore, BERZH-i në përputhje me Kërkesat e tij të Performancës dhe nga BEI-ja në përputhje me standardet e saj të M&S. Të gjitha boshllëqet e identifikuar u plotësuan dhe u hartua një plan korrespondues masash mjedisore dhe sociale i cili u bë pjesë e dokumentacionit kontraktual.

Në përgjithësi, VNMS-të, aty ku janë ndërmarrë, janë gjetur në përputhje me kërkesat e BEI-së. Ndër të gjitha këto projekte, ka pak ose aspak zhvendosje fizike, dhe shumica e shpronësimeve është e përkohshme për kohëzgjatjen e periudhës së ndërtimit. Përvetësimi i përhershëm i tokës kufizohet me instalimet mbi sipërfaqen e tokës. Në të gjitha rastet, janë hartuar plane për marrjen e tokës dhe kompensimin e mjeteve të jetesës, të cilat janë publikuar në faqet përkatëse të internetit. Janë përgatitur plane për përhapjen e informimit për dhe konsultimet publike, të cilat përshkruajnë procedurat e konsultimeve me palët e interesuara, si pjesë e proceseve të ndryshme të VNMS-së dhe përgjatë fazave të ndërtimit dhe zbatimit të projekteve. Të gjitha projektet përfshijnë mekanizma të brendshëm të ankesave.

Ndikimet e ndërtimit: Gjatë ndërtimit të gazsjellësit, shumica e ndikimeve mjedisore do të jenë të përkohshme dhe mund të zbuten me procedurat standarde të menaxhimit të mjedisit për ndërtimin, të plotësuar me metoda specifike të ndërtimit për kalimet e lumenjve, restaurimin e zonave të ndjeshme ekologjike, dhe procedurat e tjera specifike për mbrojtjen e specieve të rrezikuara dhe vulnerabël. Janë përgatitur dhe po finalizohen plane të përshtatshme menaxhimi sipas standardeve ndërkombëtare për këto aktivitete. Këto plane janë kusht për Projektin dhe përfshihen në Planin gjithëpërfshirës të Menaxhimit Mjedisor dhe Social.

Planet mjedisore dhe sociale të implementimit të kontraktorëve PPN, si dhe planet e menaxhimit të kontraktorëve, duhet të jenë në përputhje me planet e lartpërmendura. Ndërkohë që planet po finalizohen dhe ndërtimi po vijon, është identifikuar një boshllëk në implementim.

Rreziku i paqëndrueshmërisë së shpateve, erozioni dhe sedimentimi përbëjnë gjithashtu ndikime potenciale nga ndërtimi i gazsjellësit. Këto ndikime janë tipike për këtë lloj ndërtimi dhe mund të jenë të konsiderueshme nëse nuk menaxhohen siç duhet. Është përgatitur një Plan i veçantë për Rivendosjen dhe Kontrollin e Erozionit për Projektin, i cili përfshin masat e nevojshme parandaluese dhe lehtësuese për të garantuar që ndikimet të jenë të përkohshme dhe minimale. Ekzistojnë shumë rreziqe potenciale natyrore që shoqërohen me kushtet aktive gjeologjike të zonës së Projektit, kryesisht në Greqi dhe Shqipëri. Këto rreziqe janë vlerësuar dhe të gjitha strukturat janë projektuar që të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare sizmike të kërkuara.

Cilësia e ajrit të ambientit: pritet që të ndikohet nga emetimet e pluhurit prej aktiviteteve të ndërtimit. Burimet kryesore të emetimeve të pluhurit gjatë ndërtimit janë: gjermimet, shpërthimet dhe punimet në tokë; ngarkimi/shkarkimi, manovrimi, depozitimi dhe transportimi i materialeve

ose mbetjeve; dhe lëvizjet e mjeteve. Emetimet nga tymi i automjeteve të përdorura për transportin e punëtorëve, materialeve të ndërtimit, automjetet dhe pajisjet do të minimizohen nëpërmjet praktikave të mira, p.sh. mirëmbajtjes së duhur, kufizimit të kohës së mbajtjes ndezur dhe përdorimit të automjeteve, vetëm kur nevojiten.

Do të implementohen masa për reduktimin e pluhurit, siç përcaktohet në VNMS, të cilat përfshijnë: spërkatjen me ujë të zonave me pluhur, pezullimin e punimeve në tokë kur ka erëra të forta, mbulimin e ngarkesave, depozitimin në mënyrën e duhur të materialeve të shkrifëta/lira, mbulimin e materialeve të gërmuara dhe spërkatjen duke përdorur ujin e grumbulluar të shiut dhe ujin e ndotur në ndërtim.

Lidhur me operacionet e TPG-së dhe stacionet e kompresorëve, është kryer modelimi i emetimeve në ajër për të siguruar që limitet e cilësisë së ajrit janë brenda kërkesave kombëtare dhe të BE-së në burimin e emetimeve dhe vendndodhjet e receptorëve.

Cilësia dhe përdorimi i ujit: Cilësia e ujërave sipërfaqësore mund të ndikohet nga sedimentimi, për shkak të aktiviteteve të kalimit të lumenjve dhe shkarkimit të ujërave të zeza dhe të ndotura. Aktivitetet e ndërtimit në kalimet e lumenjve do të kufizohen në periudhat e rrjedhës së ulët dhe do të implementohen masat lehtësuese të parashikuara në VNMS-në, duke përfshirë operacionet e pompimit për të shmangur shkatërrimin e shtratit të lumit. Përveç kësaj, 115 rrjedha ujore do të kalohen duke përdorur metoda pa gërmim, në mënyrë që të minimizojmë ndikimet në cilësinë e ujit. Ujërat e zeza dhe të ndotura do të trajtohen në impiante të trajtimit të ujërave të ndotura, të krijuara në Sheshpunimet e Ndërtimit.

Nevojat më të mëdha të Projektit për ujë të freskët do të lidhen me hidro-testimin e gazsjellësit. Uji do të merret nga rrjedhat ujore lokale. Aplikohen parimet udhëzuese si dhe kërkesat kontraktuale për kontraktorët për të kufizuar marrjen dhe shkarkimin e burimeve ujore sipërfaqësore me rrjedha më të mëdha, për të siguruar marrjen në konsideratë të ndryshimeve sezonale, për të ri-përdorur ujin në hidro-test dhe për të monitoruar cilësinë e shkarkimit. Do të aplikohen gjithashtu edhe masa për të parandaluar hyrjen e specieve invazive midis rrjedhave të ndryshme ujore.

Zhurma: Burimet kryesore të zhurmës së ambientit gjatë ndërtimit do të jenë: aktivitetet e përmirësimit të terrenit, shpërthimi i shkëmbinjve, shpimet me drejtim horizontal, hidro-testimi dhe inspektimi e tharja e tubacionit. Në zonat ku ekziston rreziku i shqetësimeve nga zhurma, TAP-i do të monitorojë zhurmat dhe dridhjet gjatë ndërtimit dhe do të zbatojë masa zbutëse, si për shembull, kufizimin e aktiviteteve të ndërtimit vetëm gjatë ditës. TAP-i kërkon nga kontraktorët që të raportojnë parashikimet për zhurma dhe dridhje dhe aktivitetet që lidhen me kontrollin.

Gjatë funksionimit, burimet e vetme të vazhdueshme të zhurmës janë stacionet e kompresorëve dhe terminali pritës i gazsjellësit (TPG). Një program i kontrollit të zhurmës, i mbështetur nga modelimi i zhurmës, ka treguar se nivelet e zhurmave do të jenë brenda kufijve kombëtare të përcaktuara. Do të kryhet monitorim para funksionimit dhe gjatë funksionimit për të konfirmuar parashikimet e modelimit të zhurmës.

Punimet e grumbullimit dhe instalimi i digës izoluese në zonat pranë dhe brenda detit do të prodhojnë zhurma nënujore, të cilat kanë potencial të ndikojnë te peshqit, gjitarët detarë dhe breshkat. TAP-i ka ndërmarrë modelimin e vlerësimit të ndikimit nënujor për të informuar vlerësimet dhe masat zbutëse të tij. TAP-i do të hartojë një Protokoll Lehtësimi për Gjitarët e Detit për të menaxhuar, ndër të tjera, zhurmën nënujore.

Biodiversiteti: TAP-i do të kalojë nëpër zona të habitateve natyrore, gjysmë-natyrore dhe të modifikuara me disa tipare të vlerës së biodiversitetit, si në tokë ashtu edhe në det. Janë identifikuar mangësitë në studimet e biodiversitetit, të kryera në kuadër të VNMS-së përkatëse,

veçanërisht në lidhje me vlerësimin e habitateve kritike. Në të tri shtetet janë ndërmarrë disa studime shtesë të fushës së biodiversitetit. Këto studime kanë siguruar të dhëna shtesë për florën, mishngrënësit e mëdhenj, avifaunën, ekologjinë ujore dhe detare, si dhe zvarranikët e amfibët. Projekti nuk pritet që të sjellë ndikime të përhershme e të dëmshme në habitatin kritik, në vlerat e biodiversitetit ose në specie me interes të veçantë (SIV) dhe nuk do të konvertojë apo degradojë ndjeshëm habitatet natyrore kritike ose habitatet natyrore për një periudhë afatgjatë. Në lidhje me ndikimet në zonat e identifikuar të "Natura 2000" në Greqi dhe Itali, autoritetet përkatëse kompetente, përmes zbatimit të Direktivës për Habitatet, dhe si pjesë e procesit të miratimit të zhvillimit, kanë arritur në përfundimin se nuk do të ketë efekte të konsiderueshme në këto vende.

Është miratuar një qasje konservatore për identifikimin e habitateve kritike. Studimi i gjurmës së gazsjellësit është kryer për të shmangur sa më shumë të jetë e mundur habitatin natyror kritik, pavarësisht se, duke pasur parasysh natyrën lineare të Projektit, disa zona ishin të pashmangshme. Sipas studimeve, ndikimet e mundshme në këto habitate dhe SIV-ve të identifikuar, janë kryesisht të kufizuara në ndikime të përkohshme gjatë ndërtimit (p.sh. pastrimi i tokës dhe vegjetacionit, zhurma dhe dridhjet, prania e fuqisë punëtore etj.). Në lidhje me speciet e ndjeshme, megjithëse studimet kanë identifikuar një numër specimesh të florës dhe faunës, të listuara si specie CR, EN, VU dhe NT, asnjë prej tyre nuk ka shpërndarje të kufizuar në DeK të tubacionit ose në zonën e tij të ndikimit.

Gjithsesi, Plani Plotësues i Menaxhimit Ekologjik (MEP), në formën e tij aktuale, nuk ka arritur synimin që të jetë plotësisht në përputhje me Standardet për Biodiversitetin të BEI-së. Ndikimet e mbetjeve në habitatet kritike nuk janë matur siç duhet dhe nevojitet zëvendësim praktik për kompensimin për këto ndikime, për të arritur "Zero humbje neto" të habitateve natyrore dhe fitim neto për habitatet kritike. TAP-i do të kryejë studime të mëtejshme për të siguruar që PHN/Fitimet neto të arrihen me përfundimin e punimeve dhe rivendosjes. Plani i menaxhimit ekologjik, MEP, Vlerësimi i Habiteteve Kritike dhe Plani i Biorestaurimit kanë përfunduar.

Mbrojtja e të gjitha habitateve të identifikuar me ndjeshmëri të mesme dhe të lartë, sipas standardeve të Huadhënësve gjatë ndërtimit dhe restaurimit të duhur nga TAP-i dhe kontraktorët, parashikohen në planet e MN, planet e Kontrollit të Erozionit dhe Rivendosjes, planet e Biorestaurimit dhe planet gjithëpërfshirëse të Menaxhimit Ekologjik.

Projekti do të hartojë, së bashku me grupet e interesit dhe ekspertët kombëtarë dhe vendas, Plane Masash të Biodiversitetit, specifike për vendin, të cilat përfshijnë seksionin detar. Këto plane do të sigurojnë një udhërrëfyes të hollësishëm për menaxhimin afatgjatë dhe monitorimin e secilës prej tipareve prioritare të biodiversitetit në Planin e Menaxhimit të Kompensimit të Biodiversitetit.

Seksioni detar i TAP-it: TAP ka përfunduar studimet fillestare mjedisore bazë, marrjen e mostrave të sedimenteve, ujit dhe organizmave detare. Studimet mjedisore tregojnë një batimetri të thellë, të përbërë nga balta dhe rëra. Studimet mjedisore bazë nuk kanë gjetur veçori të ndjeshme në shtratin e detit, ku sasia dhe shumëllojshmëria e specieve të makrofaunës rezulton e ulët. Ndikimet nga gërryerja në planktone, organizmat detare jovetebrore dhe komunitetet e peshqve e habitateve të tyre, janë vlerësuar si mesatare gjatë aktivitetëve aktuale të gërryerjes. Për shkak se sedimentet në zonë janë kryesisht më shumë materiale ranore sesa sedimente të imëta, ndikimet e gërryerjes (përkatësisht turbullira) me shumë gjasa do të kufizohen dhe do të kenë kohëzgjatje të shkurtër. Gjitarët detarë dhe breshkat, duke përfshirë zogjtë e detit, janë vëzhguar gjatë studimit dhe do të përfshihen në programin e monitorimit dhe planet e menaxhimit të kontraktorëve. Cilësia e ujit dhe e sedimenteve është konstatuar përgjithësisht e mirë. Modelimi i sedimenteve ka përfunduar dhe është hartuar një Program i fortë Monitorimi Detar. TAP-i do të përfundojë studimet e shtratit të mjedisit detar dhe kolonës ujore dhe do të zhvillojë një plan menaxhimi ekologjik detar me vlerësimin e habitateve kritike shoqëruese. Përveç kësaj, TAP-i do të përfundojë Protokollin e Lehtësimit për Gjitarët e Detit, i cili synon të identifikojë dhe të lehtësojë të gjitha ndryshimet e konsiderueshme në mjedisin detar.

Ndër rreziqet e tjera të mundshme gjatë ndërtimit të sektorit detar përfshihen: ndotja e ujit nga derdhjet aksidentale të hidrokarbureve (p.sh. karburant, graso dhe vajra) ose substanca të tjera nga varkat dhe anijet e punës, pajisjet dhe makineritë e përdorura. Këto ndikime, përgjithësisht, mund të shmangen me procedura standarde pune të tilla si karburantet e biodegradueshme dhe duke monitoruar cilësinë e ujit gjatë fazës së ndërtimit.

Trashëgimia kulturore: Janë kryer studime dhe vlerësime bazë për trashëgiminë kulturore, si pjesë e proceseve të VNMS-së dhe zonat e ndjeshme nga ana kulturore janë shmangur deri në shtrirjen e mundur për përzgjedhjen e rrugës. TAP-i është angazhuar me ekspertë arkeologjikë në vend përgjatë këtij procesi. Krijimi i procedurave për gjetjet rastësore për konstatimet e paparashikuara është kryer në përputhje me legjislacionin kombëtar të vendit pritës dhe Standardet e aplikueshme të Huadhënësve.

Vlerësimi social

Blerja e tokës dhe restaurimi i mjeteve të jetesës: Një parim kyç në marrjen e tokës është shmangia dhe minimizimi i zhvendosjeve fizike të shtëpive deri në shkallën më të madhe të mundshme. TAP-i e arriti me sukses këtë objektiv nëpërmjet planifikimit të kujdesshëm fillestar që parashikonte shmangien e të gjitha fshatrave dhe qyteteve ose kryerjen e devijimeve të mëvonshme të rrugës (disa prej të cilave kërkonin një shtojcë të VNM-së) për të shmangur çdo ngastër toke apo fermë që hasej në finalizimin e DeK të tubacionit.

Projekti do të ndikojë afërsisht te 45 000 pronarë dhe përdorues tokash përgjatë korridorit të tubacionit. Proceset e Servitudit dhe Marrjes së Tokës (SMT) janë kryer në përputhje me legjislacionin dhe rregullat kombëtare, si dhe me standardet ndërkombëtare, duke përfshirë standardet e BEI-së. TAP-i do të garantojë që të gjithë personat e prekur të trajtohen me respekt, të ndihmohen gjatë procesit ligjor dhe të kompensohen në masën e duhur. Një pjesë e mirë e programit të SMT-së ka përfunduar, ndërkohë që aktualisht po kryhen punë shtesë për SMT-në për shkak të devijimeve të rrugës dhe tokës shtesë të nevojshme. Në përgjithësi, ajo përfshin afërsisht 21 000 parcela toke: 10 200 në Greqi, 10 300 në Shqipëri dhe rreth 200 në Itali. Blerja dhe kompensimi i tokës nuk ishte një proces i lehtë sepse kërkohej që TAP të adresonte kryesisht ndikimet e përkohshme në jetesën dhe aktivitetet e një numri shumë të madh familjesh, të ndërlukuara nga sistemet komplekse të përdorimit të tokës dhe strukturat shoqërore, veçanërisht në Shqipëri. U nevojiti një pjesë relativisht e vogël e tokës për kohëzgjatje të përhershme për instalime mbi tokë, të tilla si: stacionet e kompresorit, terminali pritës i gazsjellësit, stacionet e valvulave të bllokimit dhe rrugët e hyrjes. Pjesa më e madhe e tokës së marrë kërkohet përkohësisht për qëllime ndërtimi dhe do t'u kthehet pronarëve të vërtetë që kanë të drejtën e tokës, pas implementimit të masave të rivendosjes.

Pjesa më e madhe e ndikimeve të dëmshme në jetesë nga aktivitetet e Projektit për marrjen e tokës, do të jenë afatshkurtra dhe rrjedhin kryesisht nga shqetësimet e shkaktuara nga ndërtimi. Ndikimet përfshijnë humbjen e përkohshme dhe uljen e aksesit në tokën bujqësore, humbjen e kulturave bujqësore të rritura dhe ndikimet në pasuritë dhe infrastrukturën e komunitetit, duke përfshirë sistemet e ujitjes.

TAP-i ka krijuar një Plan Restaurimi të Jetesës (PRJ), i cili ka adresuar ndikimet në jetesë, të shkaktuara nga proceset e SMT-së të projektit. Përveç kompensimit me para, të kryer tashmë për ndikimet në tokë, jetesa (nëpërmjet programit të Ndihmës së Jetesës dhe Mbështetjes Kalimtare (NJMK) do të rikthehet në nivelet para fillimit të projektit dhe, sipas rastit, do të përmirësohet përmes një sërë përfitimesh shtesë, si mundësi punësimi, trajnime profesionale, paketa mbështetëse bujqësore, mbështetje për ndërmarrjet alternative për të diversifikuar burimet e të ardhurave të jetesës, akses në shërbime shëndetësore dhe arsim, mbështetje për grupet e grave dhe peshkimin etj.

Gjithashtu, TAP-i po implementon një program për investimin në zhvillimin e komunitetit, për të shtuar vlerë përtej lehtësimit të ndikimeve ose për krijimin e vendeve të punës që janë specifike për Projektin në zonën e ndikimit të Projektit duke promovuar zhvillimin e qëndrueshëm social dhe ekonomik nëpërmjet lidhjeve me NVM-të në rajon. Shumica e këtyre programeve janë dakordësuar në Marrëveshjet përkatëse Ndër-qeveritare për secilin nga të tri shtetet. Programet do të implementohen gjatë fazës së ndërtimit. Gjithsesi, rekomandohet që ky buxhet të shpërndahet edhe në fazën e funksionimit.

Grupet vulnerabël: Është kryer një vlerësim për grupet vulnerabël, ku grupet kryesore të identifikuar janë familjet me të ardhura të raportuara nën nivelin kombëtar të varfërisë, toka e të cilave është prekur shumë, të moshuar (të ve/që jetojnë vetëm) pa prona të tjera, me pasuri të kufizuara, akses të dobët në infrastrukturë/shërbime bazë, familje me anëtarë me probleme shëndetësore, pronarë tokash të papërdorshme. Janë në zbatim masa të veçanta për të adresuar dinamikën gjinore dhe nevojat e të varfërve nëpërmjet konsultimeve dhe komunikimit me grupet e interesit, restaurimin e mjeteve të jetesës dhe marrjen e tokës. Pronarët e tokave të mbetur me toka të papërdorshme (të tilla si parcela shumë të vogla, ose pamundësia për të pasur akses në toka gjatë periudhës së ndërtimit) u është rishikuar masa e kompensimit sipas rastit, dhe janë hartuar kritere udhëzimi për të identifikuar rastet ku duhet të jepet kompensim shtesë.

Menaxhimi i ankesave: Një mekanizëm efektiv dhe mirë-funksionues i ankesave është pjesë thelbësore e menaxhimit të marrëdhënieve me komunitetin. TAP-i ka zhvilluar një proces më vete për ankesat, për secilin shtet, për të menaxhuar ankesat që lindin nga Projekti, lidhur me marrjen e tokës, restaurimin e jetesës si dhe çështje të tjera mjedisore dhe sociale. Përveç kësaj, edhe kontraktorët ndërtimorë të TAP-it kanë zhvilluar paralelisht një proces për ankesat.

Mekanizmi i ankesave është prezantuar për personat e prekur nga Projekti, gjatë konsultimeve rreth VNMS-së. Metodatat e dorëzimit të ankesave përfshijnë një linjë direkte telefoni, zyrë vendore kontakti të Projektit, email, formularin e ankesës në faqen e internetit, diskutimin me një monitorues për koordinimin e ndërlidhjes me komunitetin ose të fushës sociale etj. Ankesat mund të raportohen edhe gjatë konsultimeve të ndryshme dhe vizitave periodike të zyrtarëve ndërlidhës me komunitetin për komunitetet e prekura. Ashtu si stafi i TAP-it edhe stafi i kontraktorit të ndërtimit janë trajnuar për konsultime publike dhe përdorimin e sistemit të ankesave. Shtrirja kohore e Procedurave për Ankesat përfshin fazat e ndërtimit dhe të funksionimit të Projektit.

Për të garantuar që ankesat të trajtohen në mënyrë të përshtatshme dhe të marrin përgjigje në kohën e duhur, TAP-i ka krijuar dhe integruar në sistemin e tij të MSSHS një bazë të dhënash gjithëpërfshirëse të ndërveprimit të grupeve të interesit për të mbajtur listat e grupeve të interesit, për të regjistruar komunikimin me grupet e interesit, si dhe për të regjistruar, monitoruar dhe raportuar ankesat.

TAP-i ka pranuar dhe përpunuar ankesat në të tri vendet. Megjithatë, aty ku ka kundërshtime të konsiderueshme për Projektin, është me interes të theksohet se shumë nga ankuesit vendosën të mos ndjekin as procedurën e përgjithshme të ankesave të TAP-it dhe as procedurën e ankesave sipas programit SMT. Për këtë arsye, TAP-it iu kërkua që të rishikojë procedurat e veçanta të tij dhe IKP-ve për pjesëmarrjen, efikasitetin, zgjidhjen, përsëritjen, reduktimin dhe ndikimin e sigurimin e monitorimit të tendencës. Për ta bërë mekanizmin më efikas, fokusi u përqendrua veçanërisht në shqyrtimin dhe zgjidhjen e ankesave. TAP-it do t'i kërkohet që të kryejë një rishikim të pavarur të implementimit të procedurave të tij për menaxhimin e ankesave.

Shëndeti dhe Siguria në Punë: Politikat dhe procedurat e ShSP-së për menaxhimin e ndërtimit janë shqyrtuar dhe konsideruar që të jenë gjithëpërfshirëse dhe në përputhje me kërkesat e BEI-së. Gjithsesi, TAP-i do të informojë Bankën për çdo ngjarje të rëndësishme, duke përfshirë masat korrigjuese të ndërmarra ose të planifikuara për korrigjimin e situatës.

Procedurat e ShSP-së për operacionet do të përditësohen si pjesë e përditësimit dhe shqyrtimit të PMMS-së për operacionet.

Shëndeti dhe siguria në komunitet: Rreziqet potenciale për shëndetin dhe sigurinë e komunitetit përfshijnë aksidentet rrugore, aksidentet gjatë ndërtimit dhe funksionimit, të tilla si shpërthimet dhe sëmundjet ngjitëse e probleme të tjera shëndetësore dhe sigurie që lidhen me fluksin e punëtorëve gjatë fazës së ndërtimit.

Për fazën e ndërtimit, ekzistojnë Plane për Mjedisin, Shëndetin dhe Sigurinë për secilin kontraktor ndërtimi, me qëllim reduktimin e rreziqeve dhe ndikimeve në komunitetet vendase nga aktivitetet e përgatitjes së tokës dhe të ndërtimit. Zona mbrojtjeje janë përcaktuar përgjatë DeK-së, ku nuk do të lejohet asnjë ndërtim tjetër, për të minimizuar rrezikun e aksidenteve. Praktikrat dhe kërkesat e mëtejshme të menaxhimit janë përshkruar në Planet e Menaxhimit të Mbetjeve, Mjedisit, Shëndetit dhe Sigurisë. Planet identifikojnë qartësisht rolet dhe përgjegjësitë, kërkesat përkatëse rregullatore, trajnimet dhe procedurat, duke përfshirë trajnimin për ndërveprimin me komunitetet dhe ndërgjegjësimin kulturor për të përmbushur angazhimet që lidhen me shëndetin dhe sigurinë e komunitetit në VNMS.

Një ndikim kyç i mundshëm në fazën e funksionimit lidhet me rreziqet e sigurisë për komunitetet që jetojnë ose punojnë përgjatë DeK-së. Dështimi i mundshëm i tubacionit gjatë fazës së funksionimit mund të sjellë kushte pasigurie (ndër të tjera shpërthim, re avulli). Këto rreziqe nuk kanë gjasa të materializohen, duke pasur parasysh tiparet e sigurisë së projektimit të gazsjellësit (gaz natyror, 100% nën tokë, sistem SCADA, mbrojtje katodike) dhe adresohen në mënyrë të përshtatshme në Planet e Gatishmërisë dhe Reagimit ndaj Emergjencave. Pavarësisht natyrës së kufizuar të rrezikut aktual të pranishëm gjatë funksionimit të një tubacioni të gazit natyror, nëse komunitetet nuk janë të mirëinformuara rreth veçorive të vërteta të operacioneve dhe rreziqeve që shoqërohen me to, ata mund të kenë shqetësime të pavërteta lidhur me ndotjen e tokës dhe të ujit, dhe aksidentet e mundshme që lidhen me tubacionin. Planet e Angazhimit të Grupeve të Interesit duhet të jenë një mjet kyç për menaxhimin e këtyre çështjeve.

Menaxhimi i Rrezikut të Sigurisë: Gjatë periudhës së ndërtimit, zonat e punës janë të rrethuara me gardh ose me pengesa dhe të pajisura me sinjalistikën e duhur paralajmëruese, dhe personeli i sigurisë kryen kontrollë në bazë të një Vlerësimi të Rrezikut të Sigurisë dhe sipas marrëveshjeve të shërbimit me kontraktorët. Janë kryer fushata informuese për popullatën vendase, si dhe fushata ndërgjegjësimi në shkolla për sigurinë.

Operacionet e sigurisë të TAP-it janë kontraktuar te palë të treta private nëpërmjet Kontraktorëve të NPI-së dhe drejtohen nga personeli i sigurisë i TAP-it. Pas një vlerësimi të rrezikut të sigurisë, personeli i sigurisë i TAP-it nuk është i armatosur. Është hartuar një Politikë gjithëpërfshirëse Sigurie dhe një Plan Sigurie për fazën e ndërtimit, që përfshijnë rolet dhe përgjegjësitë, kodin e sjelljes, procedurat për angazhimin me forcat e sigurisë publike dhe forcave e zbatimit të ligjit, trajnimet (duke përfshirë ndërveprimin me komunitetet përreth) dhe protokollat e reagimit në rast incidentesh të sigurisë. Filozofia e TAP-it bazohet në Parimet Vullnetare për Sigurinë dhe të Drejtat e Njeriut (PVSDNj) dhe Kodin Ndërkombëtar të Sjelljes për Ofruesit Privatë të Shërbimeve të Sigurisë. TAP-i po punon gjithashtu ngushtë me Vigjilencën Ndërkombëtare për implementimin e PVSDNj-ve të saj. Deri më sot, incidentet e sigurisë kanë qenë të kufizuara në incidente me pasoja të ulëta. Megjithatë, këto raportohen tek autoritetet vendore të zbatimit të ligjit, të cilat hetojnë incidentet.

Në fazën e operacioneve, do të markohet rruga e gazsjellësit në mënyrë që komunitetet të vihen në dijeni për rrugën e gazsjellësit. Instalimet mbi sipërfaqen e tokës do të rrethohen me gardh, duke kontrolluar dhe mbikëqyrur aksesin, për të zvogëluar rrezikun e hyrjes së paautorizuar. Do të ndërmerren masa shtesë për sigurinë në fazën e operacioneve, si pjesë e PMMS-së për operacionet.

Konsultimet Publike dhe Angazhimi i Grupeve të Interesit

TAP-i ka angazhuar palët e interesuara që prej vitit 2008 përmes një dialogu të strukturuar, të vazhdueshëm, si proaktiv ashtu edhe sipas ligjit. Janë përdorur një shumëllojshmëri kanalesh për të komunikuar me grupet e interesit, duke përfshirë (i) Zyrat e Projektit (pikat e informimit, zyrat e ndërlidhjes me komunitetin), (ii) pikat informative dhe proceset e afishimit publik, (iii) takimet individuale dhe në grupe të vogla, veçanërisht me zyrtarët qeveritarë, (iv) takimet publike/me komunitetin, (v) broshurat dhe posterët, (vi) faqja e internetit e TAP-it, (vii) mediat sociale, (viii) mediat elektronike (radio dhe TV), si dhe (ix) media e shtypur (gazetat dhe botimet).

Si pjesë e procesit të VNMS-së, TAP ka angazhuar gjerësisht grupet e interesit në secilin vend. Megjithatë, për shkak të kërkesave logjistike dhe për personel të konsultimeve në të tri vendet përgjatë rrugës së gazsjellësit, TAP-i i nën-kontraktoi konsultimet dhe si rezultat, cilësia e konsultimeve në disa vende ka qenë më e dobët. Përveç kësaj, duke pasur parasysh sasinë e informacionit që duhej të sigurohej në një kohë të shkurtër, kishte mangësi të konsiderueshme dhe të pashmangshme informacioni. Në përgjithësi, në të tri vendet, TAP ka realizuar më shumë se 160 takime me grupet kombëtare, rajonale dhe vendore të interesit midis tetorit 2012-korrikut 2013.

TAP-i ka zhvilluar një Strategji për Angazhimin e Grupeve të Interesit (SAPI) që përcakton qëllimin dhe drejtimin e aktiviteteve të angazhimit gjatë fazave të ndërtimit dhe komisionimit. Objektivat e veçanta të saj janë (i) të përshkruajë angazhimin e planifikuar të grupeve të interesit (API) gjatë fazës së konsultimeve të TAP-it dhe (ii) të sigurojë konsultime të rregullta, të aksesueshme dhe transparente me palët e interesuara. Ajo siguron një kornizë për zhvillimin e marrëdhënieve konstruktive afatgjata, të bazuara në një dialog dhe komunikim të dyanshëm, si dhe identifikimin e vazhdueshëm të grupeve të interesit, analizën, hartimin dhe priorizimin, konsultimin dhe angazhimin, identifikimin e reziqëve dhe të problemeve, shpërndarjen e informacionit. Angazhimi dhe veprimet e kërkuara përcjellëse janë të dokumentuara. Edhe me këtë Strategji, shumica e takimeve janë kryer me institucionet vendore dhe teknike, dhe angazhimi me komunitetet vendase gjatë procesit të VNMS-së ka qenë i kufizuar në anketa social-ekonomike, grupet e fokusit dhe shkëmbim letrash.

Pavarësisht se TAP-i ka kryer një numër të konsiderueshëm konsultimesh me grupet e interesit, veçanërisht lidhur me procesin e servitudit të tokës, angazhimi në konsultime domethënëse ka qenë i pamjaftueshëm, duke sjellë kundërshtimin e Projektit në Greqi dhe Itali në veçanti për çështje që lidhen me mjedisin. Dobësia në procesin e angazhimit të TAP-it ishtin përshtypjet e pamjaftueshme për grupet e interesit dhe transparenca në vendim-marrje. Shpeshherë, nuk ishte e qartë për grupet e interesit mënyra se si do të informoheshin për vendimet e Projektit dhe se si janë përfshirë kontributet dhe pikëpamjet e tyre. Si rezultat, dhe për t'u angazhuar më efektivisht me kundërshtimet në Greqi, TAP-it iu desh që të shqyrtojë procesin e vet të angazhimit dhe aktualisht po aplikon qasjen e re e cila përmban më shumë teknika dhe metodologji pjesëmarrjeje në proces, në mënyrë që të krijojë më shumë mundësi për ndërveprim domethënës midis Projektit dhe grupeve të prekura të interesit. Banka do të kërkojë nga TAP-i që të garantojë përmirësime shtesë në qasjen e lartpërmendur, duke përfshirë masat e theksuara nga Huadhënësit, për të zvogëluar me efikasitet rrezikun e një përshkallëzimi të konfliktit dhe të përmirësojë lejen e saj sociale në lokalitetet përkatëse. TAP-i kërkohet që të raportojë rregullisht pranë Bankës mbi progresin e arritur.

Kjo qasje e re mund të duhet të zbatohet edhe në kontekstin italian ku tensionet kanë penguar TAP-in të kryejë aktivitetet e veta para-ndërtimore, dhe ku është shënuar kundërshtim fizik ndaj Projektit.

Aspekte të tjera sociale dhe mjedisore

Sistemet e Menaxhimit Mjedisor, Social, të Shëndetit dhe Sigurisë: Një nga kushtet parimore të BEI-së është krijimi i një Sistemi Menaxhimi të MSShS-së, i cili do të ndiqet nga Projekti gjatë të gjithë kohës, duke përfshirë kontraktorët dhe nënkontraktorët PPN gjatë fazave të ndërtimit dhe funksionimit. TAP-i ka zhvilluar një sistem gjithëpërfshirës të menaxhimit të MSShS-së, duke përfshirë planet e menaxhimit, sistemet organizative dhe dokumentacionin implementues, që përbëjnë boshtin operacional të të gjithë SMMS-së, siç kërkohet nga politikat e BEI-së. TAP-i mban përgjegjësi të plotë për të gjitha aspektet e implementimit të këtyre planeve, pavarësisht marrëveshjeve që mund të ketë arritur me kontraktorët e tij, në lidhje me performancën, mbikëqyrjen dhe përgjegjësinë ligjore.

TAP-i zbaton një sistem të integruar të menaxhimit, i cili është i organizuar në mënyrë të tillë që të jetë në përputhje me një sërë standardesh ISO, duke përfshirë ISO 29001 (sistemi i menaxhimit të cilësisë për organizatat e ofrimit të produkteve dhe shërbimeve për industrinë e gazit natyral, naftës dhe kimikateve të naftës; ISO 14001 (mjedisi); OHSAS 18001 (siguria dhe shëndeti në punë) dhe ISO 9001 (cilësia). Sistemi dhe komponentët e tij do të përditësohen mbi një bazë të vazhdueshme, për të reflektuar informacionin e ri dhe, kur të ketë përfunduar ndërtimi, për të reflektuar kërkesat specifike të operacioneve të Projektit.

Secili kontraktor ndërtimi që do të angazhohet me TAP-in duhet të zhvillojë një sistem menaxhimi të MSShS-së që është projektuar të menaxhojë aspektet e MSShS-së të aktiviteteve të tyre dhe të implementojë Plane Implementimi Mjedisore dhe Sociale (PZMS). Sistemet e menaxhimit të kontraktorit duhet të përfshijnë burimet e nevojshme dhe të mjaftueshme njerëzore dhe operacionale për implementimin e PZMS-ve, si dhe për regjistrimin e raportimin e përputhshmërisë me kërkesat e tyre, veçanërisht në lidhje me treguesit kyç që aplikohen për performancën që janë përcaktuar në dokumentet e korporatës.

Sistemi i Menaxhimit të TAP-it përfshin politika korporative për Shëndetin dhe Sigurinë, Mjedisin dhe Marrëdhëniet me Komunitetin, si dhe një Kod të Sjelljes, i cili ofron udhëzimet bazë për të ndihmuar punonjësit e kompanisë që të marrin vendime ligjore dhe etike në lidhje me Projektin.

Regjistri i Ndikimit Mjedisor dhe Social të Rrugës: VNMS-ja dhe dokumentet PPIH sigurojnë një pasuri informacioni bazë dhe analizë të ndikimit, së bashku me një sërë masash menaxhimi dhe lehtësimi që klienti është zotuar për t'i implementuar. Këto angazhime janë të shpërndara nëpër seksione të ndryshme të dokumentacionit dhe janë të dyfishta. Fillimisht, TAP-i pati vështirësi në organizimin e këtyre angazhimeve në veprim, në mënyrë që të zhvillohej programi i menaxhimit mjedisor dhe social. Për kapërcimin e kësaj është përgatitur një listë gjithëpërfshirëse e të gjitha angazhimeve në një Regjistër për Ndikimin Mjedisor dhe Social të Rrugës, duke përcaktuar qartë çdo angazhim, burimin e tij origjinal, përgjegjësinë e qartë për implementimin dhe çfarë do të mbulojë ky angazhim në planin e menaxhimit. Ky është një mjet i vlefshëm, që shërben si një lidhje midis dokumentacionit për VNMS-në dhe PPIH-në me sistemin e menaxhimit. Ai përbën një mekanizëm, ku mund të ndiqen angazhimet e bëra përmes veprimeve në terren, duke u përcjellë kontraktorëve auditimet financiare të hollësishme dhe specifike sipas vendit.

Menaxhimi i Kontraktorëve: Faza e ndërtimit e Projektit mbart rrezikun më të madh për sa i përket ndikimit të mundshëm mjedisor dhe social dhe ngjarjeve të paparashikuara. Realizimi i punëve nga ana e kontraktorëve të ndërtimit, të përfshirë në Projekt, në mospërputhje me praktikën e mira ndërkombëtare mund të sjellë ndikime negative në M&S. Për këtë arsye, menaxhimi aktiv nga ana e TAP-it e realizimit të punës nga kontraktori për çështjet e M&S është tepër e rëndësishme për të siguruar rezultate të suksesshme dhe për të parandaluar veprime korrigjuese të shtrenjta. Sasia e kohës dhe niveli i përpjekjeve që kërkohet nga ana e TAP për menaxhimin efektiv të kontraktorit u nënvlerësua në fillim të Projektit, pasi kontraktorët nuk

kishin kuptuar plotësisht të gjitha angazhimet e tyre në lidhje me menaxhimin e M&S. Kontraktuesit nuk e kuptonin domosdoshmërisht se çfarë sanksiononin kërkesat e M&S në aspektin e implementimit, dhe u mungonin kapacitetet për të implementuar llojin e planeve të menaxhimit të kërkuara nga TAP-i. Si rezultat, dhe me kërkesë të huadhënësve, TAP-i rriti ndjeshëm numrin e stafit të M&S në terren, në të tri vendet dhe përmirësoi strukturën organizative të Sistemit të vet MSShS.

Janë hartuar Planet Kontrolluese të Kontraktorit (PKK-të), të cilat i kthyen angazhimet e bëra në dokumentacionin e VNMS-së në veprime dhe përgjegjësi të veçanta. Megjithëse mekanizmi PKK për kontrollin e kontraktorit është një mjet i dobishëm, këto PKK nuk janë rishikuar duke marrë parasysh angazhimet shtesë që ndodhen në dokumentacionin PPIH. Për më tepër, programi i ndërtimit po përgatitej mirë.

Si rezultat, TAP-it iu desh që të aplikonte kontrolle efikase menaxhimi, si dhe procese mbikëqyrjeje dhe sigurimi të kontraktorëve të NPI. Njoftimi i Huadhënësve për ndryshimet dhe proceset e raportimit të ndryshimeve të M&S dhe të Trashëgimisë Kulturore (MSTK) do të dakordësohen. Këto procese janë përfshirë në PMMS.

Plani i Reagimit ndaj Krizave dhe Emergjencave: Ekziston një sistem reagimi ndaj krizave dhe emergjencave, që përfshin Planin e përgjithshëm të Reagimit ndaj Krizave dhe Emergjencave të Projektit, i cili përcakton rolet dhe përgjegjësitë për të gjitha ekipet e reagimeve ndaj krizave dhe emergjencave, përcakton ndërfaqet dhe komunikimin ndërmjet të gjitha ekipeve në selinë e TAP-it, zyrat vendore, zyrat e Projektit dhe organizatat kontraktore, si dhe përcakton trajnimin e rregullt të menaxherëve në detyrë dhe anëtarëve të ekipit. TAP-i kërkon që strategjitë e kontraktorëve të tij për reagimet ndaj krizave dhe emergjencave të jenë në përputhje me TAP-in dhe që këto të përcaktohen në dokumentacionin e kontraktorit. Procedurat janë pjesë përbërëse e SMMS-ve dhe OHSAS, dhe përfshijnë edhe plane të veçanta për emergjencat mjekësore dhe mjedisore, të cilat janë hartuar në konsultim me ofruesit kombëtarë të shërbimeve të emergjencës dhe institucionet vendase të kujdesit shëndetësor. Këto plane përfshijnë të gjithë kontraktorët e NPI-së, si dhe nën-kontraktorët.

SMMS-të e operacioneve do të përfshijnë planin e reagimit ndaj krizave dhe emergjencave.

Studimi i Gjurmës së Karbonit i BEI-së

Kur TAP të vendoset plotësisht në funksionim dhe të punojë me kapacitet të plotë, ai do të transportojë 10 Gm³ gaz natyror në vit. Emetimet absolute të CO₂ si pasojë e Projektit përlllogaritjen të jenë 476 kiloton CO₂eq/vit. Kjo përbëhet nga 425 kiloton CO₂eq/vit nga djegia e gazit natyror në stacionet e kompresorit dhe 51 kiloton CO₂eq/vit nga rrjedhjet. Faktori i emetimit, i përdorur për llogaritjen e djegies së gazit natyror është 56,1 ton CO₂/TJ.

Meqenëse prodhimi i brendshëm i gazit natyror në BE është në rënie më të shpejtë se kërkesa, importet pritet të rriten. Për përmbushjen e kërkesave në rritje për importe, alternativa bazë për korridorin jugor të gazit është rritja e importeve ruse dhe GNL-së së SHBA-së.

Importet e tjera ruse mund të dërgohen ose nëpërmjet rrugës ekzistuese tranzite nëpërmjet Ukrainës, ose përmes tubacionit të planifikuar Nord Stream 2. Emetimet nga opsioni i tranzitit nëpërmjet Ukrainës janë më të larta krahasuar me TAP-in (për shkak të vjetërsisë dhe projektit të sistemit ukrainas të transmetimit). Nuk ka të dhëna për përdorimin e karburantit nga gazsjellësi i ardhshëm Nord Stream 2. Gjithsesi, përdorimi i karburantit për njësi për kompresimin në Nord Stream 2 do të jetë më i lartë sesa në TAP për shkak të presionit shumë më të lartë të projektuar. Kështu, lidhur me dy mundësitë alternative të eksporteve ruse (tranziti nëpërmjet Ukrainës dhe Nord Stram 2), përdorimi i karburantit dhe emetimet relative të TAP-it do të jenë më të ulëta. Duke qenë se nuk dihet sasia e saktë e përdorimit të karburantit në Nord Stream 2, supozimet e matura që gjejnë vend në këtë rast janë se emetimet relative janë të

paktën të barabarta me ato të TAP-it, prandaj edhe përlogaritja më e kujdesshme e emetimeve relative të Projektit në raport me vlerën bazë supozohet të jetë zero (dhe jo negative).

GNL-ja e SHBA-së, si një import alternativ në rritje, mund të ketë më shumë gjasa, duke marrë parasysh vendimet politike për diversifikim larg importeve ruse. Megjithatë, emetimet nga importimi i të njëjtës sasi gazi nëpërmjet GNL-së vlerësohen nga disa burime sa trefishi i emetimeve të Projektit. Meqenëse ka paqartësi se cila do të ishte alternativa e vërtetë bazë për importet nëpërmjet TAP-it, opsioni i GNL-së nuk do të përfshihet këtu. Megjithatë, marrja e opsionit të GNL-së si bazë do të sillte kursime relativisht të larta të emetimeve për Projektin.

Përfundimet dhe rekomandimet

Me aplikimin e kushteve të mëposhtme, Projekti është i pranueshëm për financim në aspektin mjedisor dhe social.

Para nënshkrimit:

- TAP-i siguron konfirmimin e autoriteteve kompetente kombëtare të Greqisë dhe Shqipërisë që asnjë zonë e mbrojtur dhe me rëndësi konservimi të mos ndikohet ndjeshëm nga Projekti;
- TAP-i do të përgatisë dhe finalizojë Planin e Masave Mjedisore dhe Sociale për të reflektuar detyrimet e përcaktuara të monitorimit të brendshëm dhe të jashtëm;
- Do të dorëzojë një Strategji përfundimtare Kompensimi, të pranueshme nga BEI-ja për të arritur "Zero humbje neto" dhe "Fitim neto" për ndikimet e mbetjeve në habitatet kritike, si dhe planet ekologjike që shoqërojnë ato;
- Do të bëjë të gjitha përpjekjet dhe do të vendosë në lëvizje burimet për zgjidhjen e çështjeve të besimit të komunitetit dhe lejeve sociale në Greqi, duke përfshirë krijimin e një Komiteti Teknik të Pavarur dhe angazhimin e ekspertizës për menaxhimin e konfliktit dhe të zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve;

TAP-i merr përsipër që:

- Të mbajë gjatë ndërtimit dhe funksionimit të projektit një Strukturë të Integruar të Menaxhimit të Projektit, të përbërë nga ekspertët e TAP-it dhe ekspertë ndërkombëtarë të jashtëm dhe vendorë;
- Të sigurojë që Projekti (duke përfshirë të gjitha punët e kryera nga kontraktorët) të kryhet në përputhje me dispozitat që përmbahen në dokumentet e VNMS-së, PMMS-së dhe planet përkatëse të menaxhimit dhe masave, dhe PVMS;
- Të finalizojë Planin e Menaxhimit të Kompensimit të Biodiversitetit, e lidhur me Strategjinë e Kompensimit të Biodiversitetit;
- Të hartojë Plane Masash për Biodiversitetin në vend, si dhe Planin e Masave për Biodiversitetin për pjesën detare.
- Të hartojë një plan menaxhimi ekologjik detar, me vlerësimin përkatës të habitateve kritike, Programin e Monitorimit Detar, duke përfshirë Protokollin e Lehtësimit për Gjitarët e Detit;
- Të mbajë firma të pavarura monitorimi, si palë të treta, me staf dhe terma reference të kënaqshme për Bankën, për të monitoruar, në mënyrë të pavarur, progresin e

implementimit të Projektit dhe pajtueshmërinë me kushtet e paketës së VNMS-së dhe të raportojnë rregullisht pranë Bankës;

- Të caktojë një firmë të jashtme monitorimi, të pavarur, si palë e tretë, me personel dhe terma reference të kënaqshme për Bankën, për të monitoruar implementimin e Planit të Menaxhimit Ekologjik, Strategjisë së Rivendosjes, Strategjisë së Kompensimit dhe të gjitha aktivitetet e papërfunduara nga ndërtimi, si dhe aktivitetet që lidhen me operacionet e përfshira në paketën e VNMS-së;
- Të njoftojë Bankën për çdo ngjarje të rëndësishme mjedisore, shëndetësore dhe të sigurisë në punë brenda dy ditëve pas shfaqjes së shqetësimit; dhe të dorëzojë pranë Bankës, brenda 30 ditëve, një raport përmbledhës që përfshin një përshkrim të kësaj ngjarjeje domethënëse dhe masat që TAP-i po ndërmerr ose planifikon të ndërmarrë për të adresuar këtë ngjarje dhe për të parandaluar ndonjë ngjarje të ngjashme në të ardhmen;
- Të mbajë një mekanizëm për zgjidhjen e ankesave dhe të përfshijë një Komision të pavarur Apeli për Zgjidhjen e Ankesave për adresimin e ankesave që nuk zgjidhen nga mekanizmi i ankesave të TAP-it në lidhje me implementimin e paketës së VNMS-së, duke përfshirë PMTRJ-të;
- Të kryejë një rishikim të pavarur mbi implementimin e mekanizmit të ankesave
- Të krijojë Komitetin Teknik të Pavarur në të tri vendet për të adresuar shqetësimet e komunitetit lidhur me çështjet e M&S të Projektit;
- Të përditësojë SMMS-të, PMMS-të dhe planet, politikat e procedurat përkatëse për fazën e funksionimit, të kënaqshme këto për Bankën, jo më vonë se 3 muaj para fillimit të fazës së funksionimit;
- Të dorëzojë pranë Bankës një studimin mbi vlerësimin e ndikimit për rezultatet e aktivitetëve të PMTRJ-së të kryera nga TAP-i, jo më vonë se një vit pas përfundimit të të gjitha aktivitetëve të risistemimit dhe kompensimit;
- TAP të hartojë Termat e Referencës, të dakordësuara me Huadhënësit, për një panel ekspertësh këshillues për të monitoruar Projektin në të tri vendet, duke u fokusuar në pajtueshmërinë me standardet ndërkombëtare.